REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 dhjetor 2019
Nr. ref.: RK 1471/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI176/18, KI183/18 dhe KI06/19

Parashtrues

Zeqir Demaku, Jahir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, Isni Thaçi, Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 158/2018, të 26 shtatorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI176/18 është dorëzuar nga Zeqir Demaku, Jahir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku nga Gllogoci; Kërkesa KI183/18 është dorëzuar nga Isni Thaçi nga Prishtina, i përfaqësuar nga Artan Qerkini, Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" Sh. p. k; Kërkesa KI06/19 është dorëzuar nga Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj nga Gllogoci (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 158/2018 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 26 shtatorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) lidhur me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

4. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 po ashtu pretendojnë se Gjykata Supreme, me vendimin e kontestuar, i ka shkelur të dënuarit S. S. të drejtën e tij të garantuar me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës.

5. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *"të ndaloj ekzekutimin e vendimit të kontestuar"*.

6. Parashtruesit e kërkesës KI06/19 kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *"pezullimin e procedurës së ekzekutimit të dënimeve nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, lëndët me numër ED: 123, 125, 126 dhe 127, deri në vendosje të kësaj lënde nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës"*.

Baza juridike

7. Kërkesat bazohen në nenin 113, paragrafi 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe rregullin 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 30 maj 2018, Gjykata Kushtetuese nxori Aktgjykimin në rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, parashtrues: *Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017 (ne tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi i Gjykatës në rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17). Gjykata e

shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017.

9. Më 7 nëntor 2018, parashtruesit e kërkesës KI176/18 dorëzuan në Gjykatë kërkesë për zbatimin dhe sqarimin e Aktgjykimit në rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17 dhe për sqarim të këtij Aktgjykimi.

10. Më 14 nëntor 2018, parashtruesit e kërkesës KI176/18 njoftuan Gjykatën se e tërheqin kërkesën për zbatimin dhe sqarimin e Aktgjykimit në rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17.

11. Në të njëjtën ditë, parashtruesit e kërkesës KI176/18 dorëzuan në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar.

12. Më 15 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues në lidhje me kërkesën KI176/18 dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci.

13. Më 19 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës KI176/18 për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

14. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës KI183/18 dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

15. Më 29 nëntor 2018, në pajtim me rregullin 40 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI183/18, me kërkesën KI176/18. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jetë e njëjtë me atë që ishte vendosur nga Kryetarja për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues në rastin KI176/18.

16. Më 30 nëntor 2018, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës KI183/18, parashtruesit e kërkesës KI176/18 si dhe Gjykatës Supreme për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.

17. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesit e kërkesës KI06/19 dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

18. Më 17 janar 2019, në pajtim me rregullin 40 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI06/19, me kërkesat KI176/18 dhe KI183/18. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jetë e njëjtë me atë që ishte vendosur nga Kryetarja për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues në rastin KI176/18.

19. Më 22 janar 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës KI06/19, parashtruesit e kërkesës KI176/18, përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës KI183/18 si dhe Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës KI06/19 dhe për bashkimin e kërkesave.

20. Më 30 janar 2019, parashtruesit e kërkesës KI06/19, dorëzuan në Gjykatë 4 (katër) formularë të kërkesës të nënshkruara nga ta, ku kishin përfshirë vetëm informatat personale dhe kishin cekur vendimin e kontestuar dhe vendimet që i kanë paraprirë vendimit të kontestuar.

21. Më 3 prill 2019, parashtruesi i kërkesës Nexhat Demaku kërkoi nga Gjykata që të trajtoj me prioritet propozimin për masë të përkohshme - ndalimin e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

22. Më 8 prill 2019, Avokati i Popullit parashtroi në Gjykatë parashtresën *"Mendim Juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës"* në lidhje me rastin KI176/18, përmes të cilës paraqiti vlerësimin e këtij institucioni kushtetues ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 158/2018, të 26 shtatorit 2018 (në tekstin e mëtejmë: *Amicus Curiae*).

23. Më 11 prill 2019, gjyqtari raportues, në pajtim me nenin 55 të Rregullores së punës, pas konsultimit me anëtarët e Kolegjit shqyrtues, miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit për të paraqitur *Amicus Curiae* në lidhje me rastin e parashtruesve të kërkesës dhe për këtë njoftoi të gjithë gjyqtarët e Gjykatës.

24. Më 12 prill 2019, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për *Amicus Curiae* të dorëzuar nga Avokati i Popullit.

25. Më 13 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

26. Më 8 nëntor 2013, Prokurori i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (Prokurori i PSRK-së) ngriti Aktakuzën (Nr. PPS88/11) kundër parashtruesve të kërkesës me dyshimin e bazuar se parashtruesit gjatë vitit 1998 kishin kryer veprën penale të sanksionuar me nenin 152 [Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës] në lidhje me nenin 31 [Bashkëkryerja] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

27. Më 27 maj 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin (P58/14), me të cilin shpalli fajtor parashtruesit e kërkesës për veprat penale të lartcekura dhe i dënoi ata si në vijim: Isni Thaçin, Zeqir Demakun dhe Jahir Demakun, secilin me nga 7 (shtatë) vjet burgim, ndërsa Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj, si dhe Fadil Demakun dhe Nexhat Demakun me nga 3 (tre) vjet burgim secilin.

28. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesat e tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P58/14) të 27 majit 2015, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal. Parashtruesit e kërkesës kontestuan, ndër të tjera, përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore.

29. Ankesë parashtroi edhe Prokurori i PSRK-së, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke kërkuar që të rritet dënimi në mënyrë adekuate për të gjithë parashtruesit e kërkesës.

30. Më 14 shtator 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 456/15), refuzoi ankesat e Prokurorit të PSRK-së dhe parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (P58/14). Gjykata e Apelit *ex-officio* ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore sa i përket parashtruesve të kërkesës Isni Thaçi, Zeqir Demaku dhe Jahir Demaku, duke konsideruar veprën penale për të cilën ishin dënuar si vepër penale në vazhdim. Gjithashtu, Gjykata e Apelit ndryshoi dënimet e caktuara nga Gjykata Themelore në lidhje me Isni Thaçin nga 7 (shtatë) vjet, në 6 (gjashtë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim, ndërsa për parashtruesit e kërkesës Zeqir Demaku dhe Jahir Demaku nga 7 (shtatë) vjet në 6 (gjashtë) vjet burgim.

31. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P58/14) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 456/15), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal. Parashtruesit pretenduan, ndër të tjera, se përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, respektivisht, caktimi i gjyqtares [A. A. G] në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, ishte në kundërshtim me rregullat e zbatuara nga ana e EULEX-it.

32. Më 19 korrik 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit (Pml. KZZ. nr. 322/2016) refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtrueseve të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, lidhur me kundërshtimet e parashtruesve për zbatimin e rregullave për përzgjedhjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore, arsyetoi se "*caktimi i gjyqtares [A. A. G] nuk mund të cilësohet si shkelje e nenit 384 (1.1) ose e nenit 384 (1.2) e KPP-së. Kolegji vëren se edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje të ligjit përkatës - sikurse është kërkesa në fjalë se KPP-ja është shkelur), atëherë ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it [...]*".

33. Më 18 tetor 2017, parashtruesit e kërkesës Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku parashtruan kërkesë për rishqyrtimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

34. Më 11, respektivisht më 12 dhjetor 2017, parashtruesit e kërkesës KI176/18 dhe KI183/18 dorëzuan në Gjykatë kërkesë duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017. Kërkesat e tyre u regjistruan në Gjykatë si rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17. Parashtruesit e kërkesës pretenduan para Gjykatës se me Aktgjykimin Pml. KZZ. nr. 322/2016, të Gjykatës Supreme, iu ishte shkelur atyre e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, mes tjerash, për shkak të parregullsive në caktimin e

gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore dhe mosarsyetim të vendimeve.

35. Më 12 shkurt 2018, Gjykata Themelore hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për rishqyrtimin e procedurës penale në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 58/14, të parashtruar nga parashtruesit Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku.

36. Më 30 maj 2018, Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit në rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, gjeti shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, pasi konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. nr. 322/2016, nuk kishte dhënë një vlerësim dhe arsyetim të plotë lidhur me atë se a ka qenë caktimi i gjyqtarëve në trupin gjykues në rastin e parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Themelore në pajtim me tërësinë e dispozitave të zbatueshme ligjore.

37. Më 26 shtator 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e ri, respektivisht të dytin për rastin e parashtruesve, Pml. nr. 158/2018, me të cilin refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtrueseve të kërkesës, dhe një personi tjetër kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, lidhur me kundërshtimet e parashtruesve për zbatimin e rregullave për përzgjedhjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore, respektivisht për caktimin e A. A. G. në trupin gjykues, arsyetoi se në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk kontestohet se ajo ka qenë në këtë listë, por kontestohet se a ka qenë gjyqtare e radhës. Gjykata Supreme vlerësoi se pretendimi ishte i pambështetur, dhe rrjedhimisht gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk përbënin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara në nenin 384. par. 1. 1. dhe 1. 2 të Kodit të Procedurës Penale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 dhe KI183/18 pretendojnë shkelje të të drejtave individuale të tyre, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, të ndërlidhura me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Pretendimet e parashtruesve Zeqir Demaku, Jahir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku (KI176/18)

39. Parashtruesit e kërkesës KI176/18, fillimisht pohojnë se parregullsitë në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore i ka konstatuar Gjykata Kushtetuese, e cila *"ka thënë se mungojnë arsyet dhe nuk ka pranuar interpretimin dhe arsyetimin juridik të [Gjykatës Supreme]"*. Në lidhje me këtë, ata i referohen pjesës së Aktgjykimit të Gjykatës në rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, që ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në lidhje me arsyetimin e vendimit të Gjykatës Supreme, Pml. KZZ.

nr. 322/2016, sa i përket caktimit të gjyqtares A. A. G. në trupin gjykues të Gjykatës Themelore.

40. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 pretendojnë se Gjykata Supreme nuk ka zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese pasi gjatë rishikimit të vendimit të saj të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata Supreme nuk mund *"të përdorë arsye tjera për faktet e njëjta që tanimë kanë ndodhur [...] pos përmes përsëritjes se gjykimit me një trup të ri gjykues, ku palët kanë mundësi që në të gjitha shkallët të kenë një proces të rregullt gjyqësor, të paanshëm dhe të drejtë"*.

41. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 më tej pohojnë se *"formimi i parregullt i trupit gjykues ka ndodhur jo në [Gjykatën Supreme] por në [Gjykatën Themelore] si gjykatë e faktit"*. Andaj, sipas tyre, në kundërshtim me udhëzimet e Gjykatës Kushtetuese *"Gjykata Supreme, me vendimin e kontestuar, [...] ka rihapur procedurat gjyqësore në stadin e shqyrtimit të [kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë] të parashtruesve të kësaj kërkese, aty ku nuk kanë ndodhur shkeljet origjinare kushtetuese të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së"*.

42. Andaj, ata ankohen se, *"[Gjykata Supreme me vendimin e kontestuar] ka bërë shkelje të reja kushtetuese [...], përkatësisht cenim të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës dhe të drejtës për një proces të rregullt nga neni 6.1 i KEDNJ-së sepse nuk e ka kthyer rastin në shkallë të parë, aty ku kanë ndodhur shkeljet e të drejtave kushtetuese*", duke pohuar se Gjykata Supreme ka tejkaluar kompetencat e saj pasi ajo *"nuk mund të substituohet në vend të [Gjykatës Themelore] si gjykatë e faktit: punë e [Gjykatës Supreme] është t'i përmirësoj shkeljet ligjore, jo ato të natyrës faktike"*.

43. Parashtruesit e kërkesës KI176/18, duke ju referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI78/12, theksojnë se Gjykata Supreme *"në të kaluarën ka pasur praktikën e vet të saktë si duhet të veprohet kur [Gjykata Kushtetuese] anulon vendimet e saj: çdoherë çështja kthehet në shkallën ku është kryer shkelja kushtetuese e konstatuar me vendim të [Gjykatës Kushtetuese]. Kështu ka vepruar vetë Gjykata Supreme në të kaluarën kur vendimet e saj janë prishur nga [Gjykata Kushtetuese]"*.

44. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 i referohen edhe një rasti të Gjykatës Supreme (Aktgjykimit Pml. KZZ. nr. 223/2017) të 11 qershorit 2018, ku sipas tyre, Gjykata Supreme kishte *"konstatuar se për shkak të përbërjes jo të ligjshme të trupit gjykues në një gjykatë themelore kosovare duhet të caktohet një gjykim i ri me përbërje të re të trupit gjykues në gjykatën e faktit"*.

45. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 29 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës KI176/18 ankohen se, *"nga dita e shpalljes së pavlefshme të Aktgjykimit të [Gjykatës Supreme] Pml. KZZ. nr. 322/2016 [...], mbajtja në paraburgim e [S.S.] përbën privim pa të drejtë nga liria, përkatësisht shkelje kushtetuese nga neni 29.1 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] i Kushtetutës"*. Sipas tyre, *"[në momentin që është shpallur i pavlefshëm Aktgjykimi Pml. KZZ. nr.*

322/2016 [...] ka rënë baza ligjore për mbajtjen në burg të [S.S.], përkatësisht është dashur një bazë tjetër dhe një arsyetim tjetër ligjor për mbajtjen e tij në burg [...]".

46. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 po ashtu kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme, për të ndalur ekzekutimin e vendimit të kontestuar deri në vendosjen e rastit nga Gjykata. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pohojnë se fakti që Gjykata Supreme nuk ka marrë për bazë gjetjet e Gjykatës Kushtetuese dhe mbajta në burg e [S. S.], *"përbën një arsye shtesë për [Gjykatën Kushtetuese] për të vënë urgjentisht masën e përkohshme, ndalim ekzekutimin e vendimit të kontestuar, Aktgjykimit të [Gjykatës Supreme] Pml. 158/18, si një vendim arbitrar që është dhënë me qëllim të obstruksionit të udhëzimeve të Aktgjykimit të GJK nr. Ref. 1248/18".*

47. Në fund, parashtruesit e kërkesës KI176/18 kërkojnë nga Gjykata që kërkesa e tyre të deklarohet e pranueshme, të konstatohet që atyre u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së dhe, të shfuqizohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 158/2018.

Pretendimet e parashtruesit Isni Thaçi (KI183/18)

48. Parashtruesi i kërkesës KI183/18, pretendon se Gjykata Supreme me vendimin e kontestuar i ka shkelur atij të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, pasi në një rast të ngjashëm (nr. 938/13), kishte aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë duke konstatuar se *"shumica e anëtarëve të kolegjit janë të mendimit se ligjet përkatëse nuk e mbështesin mundësinë që cilido trup gjykues të mund të përbëhet vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it"*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës KI183/18, pohon se *"[ky qëndrim i drejtë i njërit prej kolegjeve të Gjykatës Supreme nuk është përfillur edhe nga [...] Kolegji i cili ka vendosur çështjen [e parashtruesve të kërkesës] edhe pse po ashtu në rastin [e tyre] trupi gjykues ka qenë i përbërë në tërësi vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it".*

49. Andaj, sipas tij, duke nxjerrë dy vendime të ndryshme për rrethana të njëjta *"Gjykata Supreme e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Kosovës".*

50. Sa i përket pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës, parashtruesi i kërkesës KI183/18, pohon se parakusht i një gjykimi të drejtë është paanshmëria e Gjykatës. Në lidhje me këtë, duke u thirrur në rastin e GJEDNJ-së *Driza kundër Shqipërisë,* ai pohon se sipas GJEDNJ-së *"Qëllimi i gjithë veprimtarisë së gjykatave dhe i vetë nenit 6 të Konventës është sigurimi i një gjykimi të pavarur dhe të paanshëm. Kjo nënkupton mungesë totale të paragjykimeve nga ana e trupit gjykues".*

51. Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës KI183/18 ankohet se *"[Caktimi i [A. A. G.] në trupin gjykues të këtij rasti është bërë në kundërshtim me procedurat, politikat dhe rregullat e*

përzgjedhjes së trupave gjykues. [...] Sipas listës së aplikueshme, ajo nuk ka qenë gjyqtarja e radhës së EULEX-it e cila është dashur të caktohej për këtë rast. Në kundërshtim me këtë listë, ajo është zgjedhur nga [Kryetari i trupit gjykues D. S.] si anëtare e trupit gjykues, sepse ka qenë e dashura e tij dhe, sepse ai ka dashur që ajo të avanconte në karrierën e saj, duke ia mundësuar që të gjykonte një rast të krimeve të luftës. [A. A. G.] pastaj është ngritur në një gjykatë më të lartë në Kosovë".

52. Parashtruesi kërkesës KI183/18, pretendon se *"[marrëdhënia e këtyre dy gjyqtarëve [D. S.] dhe [A. A. G.] përbënë konflikt interesi për të cilin mbrojtja nuk ka qenë në dijeni"*. Parashtruesi ka kuptuar për këtë konflikt interesi vetëm *"në nëntor të vitit 2016 [kur] mbrojta [e parashtruesit] ka marrë një numër e-mailash nga punonjësit e EULEX-it që pasqyrojnë parregullsitë në formimin e trupit gjykues [dhe] pasqyrojnë njëanshmërinë e këtij trupi. Për këtë arsye [...] është kërkuar përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it [M. S.] të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit"*, por kjo, sipas parashtruesit të kërkesës, nuk është lejuar nga Gjykata Supreme.

53. Parashtruesi kërkesës KI183/18, sqaron se *"Gjyqtarja [A. A. G.] është caktuar në trupin gjykues nga një gjykatë tjetër, sipas kërkesës së Kryetarit të Trupit Gjykues të lëndës P. 58/14. Kjo praktikë e caktimit të gjykatësve të EULEX-it nuk parashihet as me ligjin e lartcekur e as me Rregulloren përkatëse të EULEX-it për formimin e trupave gjykuese"*. Andaj, ai ngrit pyetjen se *"[çfarë kuptimi do të ketë një rregullore për mënyrën e formimit të trupave gjykues nëse e njëjta nuk zbatohet ashtu siç është shkruar"*.

54. Duke ju referuar Udhëzuesit të EULEX-it për caktimin e gjyqtarëve në raste penale, ai pohon se *"Rregullorja thotë se një gjyqtar i caktuar në Prishtinë [A. A. G.], mund të shërbejë si zëvendësues në Mitrovicë, por jo si anëtare i trupit gjykues. Qëllimi i Rregullores së EULEX-it ka qenë dhe mbetet evitimi i parregullsive dhe garantimi i paanshmërive me rastin e formimit të trupave gjykuese"*. Sipas tij, në asnjë dispozitë të Rregullores nuk parashihet e drejta e Kryetarit të Trupit Gjykues të kërkojë një anëtar të trupit gjykues nga një gjykatë tjetër siç ka ndodhë në çështjen penale P. 58/14. Andaj, ai pretendon se *"në rastin konkret kemi të bëjmë me një gjykim të parregullt nga një trup gjykues i cili nuk është formuar sipas dispozitave ligjore"*.

55. Parashtruesi i kërkesës KI183/18, për më tepër, pretendon se përkundër faktit që nga korrespodenca e-mailave [të M. S.] ishin ofruar prova të mjaftueshme për anshmërinë e trupit gjykues, këto prova nuk janë trajtuar fare dhe me mostrajtimin e pretendimeve për mungesë të paanshmërisë të trupit gjykues, Gjykata Supreme nuk ka trajtuar njërin nga pretendimet kryesore të mbrojtjes. Parashtruesi i kërkesës KI183/18 më tej i referohet rastit të GJEDNJ-së *Kyprianou kundër Qipros,* ku theksohet se *"Drejtësia nuk duhet vetëm të jepet, duhet gjithashtu të shihet se drejtësia po jepet. Kjo do të thotë se paanësia e gjykatës është e kompromet uar edhe atëherë kur ajo thjeshtë është e dyshimtë"*.

56. Parashtruesi i kërkesës KI183/18, po ashtu pretendon se në rastin e tij është shkelur edhe parimi i barazisë së armëve sepse *"Edhe pse mbrojtja kishte*

insistuar që të thirret edhe eksperti [M. G.] i cili e kishte përpiluar ekspertizën së bashku me eksperten [C. B.], kërkesa e mbrojtjes kishte hasur në vesh të shurdhër". Sipas tij, ky veprim bie ndesh me kërkesat e nenit 338, paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

57. Parashtruesi i kërkesës KI183/18, ankohet edhe se dëshmitari B. është shpallur "dëshmitar armiqësor" pa bazë ligjore, pasi KPP nuk e njeh institutin e "dëshmitarit armiqësor". Neni 2 i KPP-së përcakton se "*Vetëm gjykata kompetente, e pavarur dhe e paanshme, mund të shqiptojë sanksionin penal kryerësit të veprës penale në procedurë të filluar dhe të zbatuar sipas [KPP]*", ndërsa, "*[nuk është i qëndrueshëm konstatimi i Gjykatës [Supreme] se duhet të lejohet që dëshmitari B. të konsiderohet "dëshmitar armiqësor", duke u mbështetur në nenin 6 të [KEDNJ-së], sepse [KEDNJ] nuk mbron të drejtat e organeve shtetërore, siç është në fakt Prokuroria e Shtetit, por mbron të drejtat e njeriut në raport me organet shtetërore*".

58. Në fund, parashtruesi i kërkesës KI183/18, kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij të deklarohet e pranueshme; të konstatohet që i është shkelur e drejta e barazisë para ligjit e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe neni 53 i Kushtetutës; si dhe, kërkon që Gjykata të përcaktoj çfarëdo të drejte ose përgjegjësie për palët në këtë kërkesë që Gjykata i vlerëson të arsyeshme dhe të bazuara juridikisht.

Pretendimet e parashtruesve Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj (KI06/19)

59. Parashtruesit e kërkesës KI06/19, fillimisht pohojnë se në Gjykatë "*është duke u zhvilluar procedura lidhur me trajtimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. 158/2018 të datës 26.09.2018, e proceduar nga Jahir, Zeqir, Fadil dhe Nexhat Demaku*".

60. Në lidhje me këtë, ata kërkojnë nga Gjykata që me rastin e trajtimit të kërkesës KI176/18, të konsideroj që të gjitha atyre pretendimeve dhe kërkesave "*i bashkëngjitëm edhe ne Bashkim, Selman, Driton dhe Agim Demaj*".

61. Në fund, parashtruesit e kërkesës KI06/19, pohojnë se pasi Gjykata në rastin KI146/18, KI147/18, KI148/18, KI149/18 dhe KI150/18, kishte gjetur shkelje në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe Gjykata Supreme pas rishqyrtimit të rastit "*me ose pa dashje e ka injoruar këtë rast, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese [...] LUSIM Gjykatën [...] të kërkojë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, që e njëjta deri në vendosje nga Gjykata Kushtetuese të pezulloj ekzekutimin e vendimit për vuajtje të dënimit me burgim për lëndët [...] ED: 123, 125, 126 dhe 127*".

***Amicus Curiae* i Avokatit të Popullit**

62. Avokati i Popullit, mendimin juridik të paraqitur në cilësinë e *Amicus Curiae,* e mbështet në nenin 16, paragrafi 9 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit,

duke theksuar se *Amicus Curiae* ka për qëllim të ofrojë ndihmën juridike në funksion të mbrojtjes së të drejtave të parashtruesve të kërkesës, konkretisht, që lënda e tyre të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, siç është vendosur për rastin e S. S. nga Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin PML. KZZ. nr. 223/2017, të 11 qershorit 2018.

63. Avokati i Popullit konsideron se në rastin e parashtruesve të kërkesës, Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar nuk ka përfillur Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastet KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, sa i përket pretendimeve për përbërjen e trupit gjykues që ka vendosur rastin e parashtruesve në Gjykatën Themelore, pasi nuk e ka kthyer rastin në rigjykim, por ka nxjerrë një vendim të ri përmes të cilit refuzon kërkesat për mbrojte të ligjshmërisë.

64. Po ashtu, Avokati i Popullit pohon se Gjykata Supreme në Aktgjykimin PML. KZZ. nr. 223/2017, të njëjtë me rastin e tanishëm, kishte aprovuar pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në pjesën që ka të bëjë me pretendimet për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe lëndën e kishte kthyer për rigjykim.

65. Ai po ashtu pohon se në bazë të Aktgjykimit Agj. 1248/18 të Gjykatës Kushtetuese [Aktgjykimi në rastin KI146/18, KI147/18, KI148/18, KI149/18 dhe KI150/18, i 30 majit 2018], Gjykata Supreme sipas dispozitave të KPP-së, ka pasur për detyrë që lëndën të kthej në rigjykim.

66. Sipas Avokatit të Popullit, këto parregullsi ndikojnë edhe në uljen e besimit të qytetarëve në gjykata, përkatësisht në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

67. Në fund, Avokati i Popullit kërkon që Gjykata ta shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar, të urdhëroj Gjykatën Supreme që të zbatoj Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, si dhe të veproj në përputhje me praktikën e saj në rastin PML. KZZ. nr. 223/2017.

Pranueshmëria e kërkesës

68. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

69. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,*

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

70. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

71. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave janë palë e autorizuar, që kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 158/2018], të 26 shtatorit 2018, të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesave kanë sqaruar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, përveç parashtruesve të kërkesës KI06/19, të cilët deklarojnë se u bashkohen pretendimeve të parashtruesve të kërkesës KI176/18. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

72. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

73. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, përkundër rishikimit të rastit të tyre nga Gjykata Supreme, me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe, e drejta për barazi para ligjit. Parashtruesit e kërkesës KI176/18 po ashtu pretendojnë se Gjykata Supreme, me vendimin e kontestuar, i ka shkelur të dënuarit S. S. të drejtën e tij të garantuar me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës.

74. Parashtruesit e kërkesës KI176/18, pretendimeve të të cilëve u bashkohen parashtruesit e kërkesës KI06/19, më specifikisht, pretendojnë se:

i) Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar vendimin e saj pasi edhe përkundër shkeljeve të konstatuara nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, ka nxjerrë të njëjtin vendim;

ii) Gjykata Supreme me vendimin e kontestuar ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, dhe në kundërshtim me praktikën e saj të mëhershme ka tejkaluar kompetencat e saj pasi me gjithë shkeljet e konstatuara nga Gjykata Kushtetuese, nuk e ka kthyer rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore, por e ka rishqyrtuar rastin dhe ka nxjerrë Aktgjykim të ri;

iii) Mbajtja në paraburgim e S. S., pas shkeljeve të konstatuara nga Gjykata Kushtetuese, përbën privim pa të drejtë nga liria, përkatësisht shkelje kushtetuese nga neni 29.1 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës.

75. Parashtruesi i kërkesës Isni Thaçi KI183/18, më specifikisht pretendon se:

iv) Në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore, ku Gjykata Supreme në një rast të ngjashëm, kishte kthyer rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore pasi trupi gjykues ka qenë i përbërë në tërësi vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it, si në rastin e parashtruesit, Gjykata Supreme nuk e ka rikthyer rastin e tij në rigjykim dhe me këtë ka shkelur të drejtën për barazi para ligjit;

v) Gjykata Supreme nuk ka adresuar në mënyrën e duhur pretendimin e parashtruesve në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore, e cila ka qenë në kundërshtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në trupat gjykuese;

vi) Gjykatat e rregullta e shpallën dëshmitarin B. "dëshmitar armiqësor" në kundërshtim me ligjin dhe ua falën besimin dëshmitarëve A. dhe K., në kundërshtim me parimin *in dubio pro reo*, edhe pse gjykata gjeti se dëshmitarët A. dhe K. nuk kishin përvojë në dhënien e një versioni të saktë dhe të mirëstrukturuar të ngjarjeve.

vii) Eksperti i forenzikës mjekësore, M. G. nuk është marrë në pyetje gjatë procedurës gjyqësore, duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit.

76. Gjykata fillimisht rikujton se në Aktgjykimin e saj në rastin KI146/17, KI147/17, KI148/18, KI149/18 dhe KI150/18, kishte gjetur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. 322/2016, nuk kishte dhënë një vlerësim dhe arsyetim të plotë lidhur me atë se a ka qenë caktimi i gjyqtarëve në trupin gjykues në rastin e parashtruesve në Gjykatën Themelore në pajtim me tërësinë e dispozitave ligjore të zbatueshme. Ndërsa në lidhje me të gjitha pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës, përfshirë ato të përsëritura në kërkesën e tanishme, Gjykata tashmë ka vlerësuar se ato kryesisht

ngrenin çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë, dhe se, Gjykata Supreme, lidhur me ato pretendime kishte dhënë arsyetime të hollësishme në Aktgjykimin e saj, Pml. KZZ. nr. 322/2016.

77. Gjykata Supreme, në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës, kishte rishqyrtuar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesve të kërkesës në bazë të gjetjeve të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI146/17, KI147/17, KI148/18, KI149/18 dhe KI150/18, respektivisht në lidhje me pretendimet përkitazi me caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore.

78. Gjykata rikujton se pretendimet që kanë qenë objekt shqyrtimi në rastin e Gjykatës KI146/17, KI147/17, KI148/18, KI149/18 dhe KI150/18 dhe për të cilat Gjykata, në vendimin e mëhershëm ka konstatuar se ato ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë, nuk do të shqyrtohen sepse për të tilla pretendime veçse është marrë një vendim përfundimtar nga Gjykata. Kjo e fundit do të shqyrtojë vetëm pretendimet e reja të parashtruesve të kërkesës.

I. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të së drejtës për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

79. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë autoritetin e Gjykatës Supreme për të rishqyrtuar rastin e tyre, respektivisht për të rishqyrtuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë mbi bazën e gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese (Aktgjykimit në rastin KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17, dhe 150/17, të 30 majit 2018). Gjykata thekson se vlerësimi dhe gjetjet e saj në rastin e lartpërmendur kanë konstatuar se ka qenë Gjykata Supreme që me vendimin e saj (Aktgjykimi PML. KZZ. nr. 322/2016, i 19 korrikut 2017), kishte dështuar për të dhënë një arsyetim të plotë lidhur me atë se a ishin respektuar dispozitat ligjore me rastin e caktimit të gjyqtarëve të trupit gjykues në rastin e parashtruesve të kërkesës.

80. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se ka qenë detyrë e Gjykatës Supreme ta rishqyrtojë vendimin e saj në përputhje me gjetjet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ta njoftojë Gjykatën lidhur me zbatimin e vendimit të saj (shih pjesën operative të Aktgjykimit në rastin KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17, dhe 150/17, të 30 majit 2018).

81. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë po ashtu shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së për arsye se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar vendimin e saj, pasi edhe përkundër shkeljeve të konstatuara nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, ka nxjerrur të njëjtin vendim.

82. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse Gjykata Supreme ka rishqyrtuar vendimin e saj në përputhje me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese.

1. Në lidhje me të drejtën për vendim të arsyetuar

1.1. Parimet e përgjithshme

83. Gjykata rikujton që, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), e drejta për një gjykim të drejtë përfshinë edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.

84. Sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, GJEDNJ konsideron se, bazuar në parimet e administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen. (Shih *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, para. 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; *Papon kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 54210/00, Aktgjykimi i 7 qershorit 2001).

85. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja ka konstatuar se autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, por gjykatat duhet *"t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre"*. (Shih, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).

86. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, funksioni esencial i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë vlerësim publik të administrimit të drejtësisë. (Shih *mutatis mutandis, rastin e GJEDNJ-së Tatishvili kundër Rusisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, para. 30, 27 shtator 2001.).

87. Megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit - ato megjithatë duhet të adresojnë pretendimet që janë qendrore për rastet e tyre dhe të cilat ngriten në të gjitha fazat e procedurës (Shih rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53).

88. Gjykata rithekson se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshinë detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre me baza të arsyeshme, si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material. (Shih rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

89. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet duke pasur parasysh rrethanat e rastit. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999. para. 29, *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, para. 27, *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).

90. Gjykata thekson se, arsyetimi i vendimit duhet të sqarojë raportin ndërmjet gjetjeve në merita dhe vlerësimeve lidhur me provat e propozuara nga njëra anë, dhe, konkluzioneve ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, shih gjithashtu rastin KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

1.2. Zbatimi i standardeve/parimeve të lartpërmendura në rastin e parashtruesve të kërkesës

91. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, pas rishqyrtimit të kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, fillimisht vlerësoi përmbushjen e kritereve subjektive për përjashtimin e gjyqtares A. A. G. nga trupi gjykues, për shkak të pretendimeve se ajo ka pasur raporte të atilla me kryetarin e trupit gjykues që kanë ndikuar në anshmërinë e saj dhe nëse kishte fakte që dëshmojnë se ajo është caktuar në trupin gjykues me kërkesën e tij.

92. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar nga parashtruesit e kërkesës konstatoi se pretendimet për konfliktin e interesit me kryetarin e trupit gjykues ishin bazuar në burime të pasigurta sepse bëhej fjalë për informata të marra nga mjetet e informimit dhe e-maila anonim, të cilat janë dërguar në kopje, ndërsa gjykatat e rregullta vendimmarrjen e tyre e bazojnë në prova që janë nxjerrë sipas rregullave të ligjit penal. Për më tepër, edhe pas vlerësimit të kopjeve të e-mailave në të cilat ishin thirrur parashtruesit, Gjykata Supreme kishte konstatuar se nuk ishte dëshmuar raporti i pretenduar në mes të gjyqtares A. A. G. dhe kryetarit të trupit gjykues, ngase kryetari i trupit gjykues nuk kishte propozuar gjyqtaren A. A. G. në trupin gjykues ashtu sikurse pretendonin parashtruesit si dhe, në Gjykatën e shkallës së parë nuk kishte gjyqtar të mjaftueshëm për anëtarin e dytë të trupit gjykues, dhe se, rrjedhimisht ka qenë e nevojshme caktimi i një gjyqtari nga lista mobile.

93. Ndërsa, lidhur me pretendimin e parashtruesve për shkeljen e rregullave të Udhëzimit për caktimin e gjyqtarëve në rastet e caktuara, që ndërlidhet me kriterin objektiv të paanshmërisë, Gjykata rikujton që Gjykata Supreme, arsyetoi se *"sipas nenit 3.1. të Udhëzimit, "brenda sesionit rastet do t'u ndahen gjyqtarëve sipas sistemit numerik ku çdo rast i tretë që vjen në seksion do të ndahet për gjyqtarin A., secili rast i tretë për gjyqtarin B. dhe çdo rast i tretë për gjyqtarin C. (nr.1. për gjyqtarin A., nr. 2. për gjyqtarin B., nr. 3. për gjyqtarin C., nr. 4. për gjyqtarin A. dhe kështu me radhë). Për arsye të jashtëzakonshme (për shembull cilësinë dhe kompleksitetin e rastit dhe numrin e rasteve të besuara për secilin gjyqtar), gjyqtari caktues mund të ndaj rastet e zgjedhura në një mënyrë tjetër nga sa është përmendur më parë". Kjo dispozitë fletë për një ndarje-caktim të rastit në situata të zakonshme - fjalia e parë, dhe në situata të jashtëzakonshme - fjalia e dytë".*

94. Gjykata Supreme po ashtu arsyetoi se *"kur është fjala për përzgjedhjen e [A. A. G.] nga lista mobile, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk kontestohet se ajo ka qenë në këtë listë, por kontestohet se a ka qenë gjyqtare e radhës. Ky pretendim sërish ka të bëjë me spekulime, është i pambështetur dhe për shkaqet të cilat u cekën edhe më lart, nuk u aprovua. Gjykata Supreme, si përfundim, gjeti se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1. 1. dhe 1.2. [...]".*

95. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesave iu referua dispozitave relevante të Ligjit nr. 03/L-053 dhe Udhëzimit për caktimin e lëndëve tek gjyqtarët e EULEX-it. Për më tepër, edhe pse Gjykata Supreme vlerësoi se provat e paraqitura nga parashtruesit nuk ishin prova që ishin nxjerrë në bazë të ligjit, ajo sërish shqyrtoi nëse këto prova dëshmonin se gjatë caktimit të A. A. G. si pjesë e trupit gjykues nuk ishte respektuar radha e caktimit të gjyqtarëve, ashtu si është paraparë në Ligjin nr. 03/L-53 dhe Udhëzim për caktimin e lëndëve.

96. Gjykata Supreme ka sqaruar se Udhëzimi në fjalë përcakton mënyrën e caktimit të gjyqtarëve në trupa gjykuese në raste të zakonshme dhe jashtëzakonshme. Pas vlerësimit të provave të parashtrueseve të kërkesës, Gjykata Supreme konstatoi se provat e paparaqitura nga parashtruesit nuk dëshmuan se gjatë caktimit të përbërjes së trupit gjykues ishin shkelur rregullat për caktimin e gjyqtarëve në rastin e parashtruesve të kërkesës.

97. Andaj, si përfundim, Gjykata Supreme, duke vlerësuar provat e paraqitura para saj, vlerësoi se A. A. G. nuk ishte caktuar në trupin gjykues me urdhrin e Kryetarit të trupit gjykues ashtu siç pretendonin parashtruesit e kërkesës. Gjithashtu, Gjykata Supreme pasi analizoi rregullat për caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykuese, erdhi në përfundim se nga provat e paraqitura nuk ishte dëshmuar se tërësia e dispozitave ligjore të zbatueshme ishin shkelur me rastin e caktimit të A. A. G. në trupin gjykues.

98. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se arsyetimi nga Gjykata Supreme, duke iu referuar pretendimit të parashtruesve të kërkesës për parregullsi në lidhje me caktimin e gjyqtares A. A. G. si pjesë e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, është i qartë dhe adreson në mënyrën e duhur pretendimet e parashtruesve të kërkesës.

99. Prandaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të dëshmojnë se me vendimin e kontestuar u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

II. Në lidhje me pretendimin për shkelje të barazisë para ligjit

100. Parashtruesit e kërkesës, pretendojnë shkelje të barazisë para ligjit, e cila është e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme lidhur me përbërjen e trupit gjykues nga gjyqtarët e

EULEX-it. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se: *"Në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore, ku Gjykata Supreme në një rast të ngjashëm, kishte kthyer rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore pasi trupi gjykues ka qenë i përbërë në tërësi vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it, si në rastin e parashtruesit, Gjykata Supreme nuk ka rikthyer rastin në rigjykim dhe me këtë ka shkelur të drejtën për barazi para ligjit"*.

101. Fillimisht, Gjykata vëren se kjo çështje nuk është shqyrtuar nga Gjykata Supreme pasi që ajo në vendimin e saj është fokusuar vetëm në çështjet për të cilat Gjykata Kushtetuese ka gjetur shkelje në vendimin paraprak të Gjykatës Supreme, që ndërlidhen me çështjen e caktimit të gjyqtares A. A. G. si anëtare e trupit gjykues të Gjykatës Themelore.

102. Megjithatë, Gjykata në vijim do ta shqyrtojë këtë pretendim specifik, ku parashtruesit e kërkesës i referohen një vendimi të Gjykatës Supreme (PML. 223/17, të 11 qershorit 2018), në të cilin rast Gjykata Supreme kishte kthyer rastin në rigjykim për arsye se kishte konstatuar se përbërja e trupit gjykues vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it ishte konsideruar të jetë në kundërshtim me ligjin.

103. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, *ose status,* mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (Shih, *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e Kosovës,* Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33, shih po ashtu rastet e GJEDNJ-së *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976, para. 56; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, 16 mars 2010, para. 61).

104. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon se sipas cilës karakteristikë të identifikueshme, ose status, ata ishin të diskriminuar në procedurat para Gjykatës Supreme.

105. Megjithatë, lidhur me pretendimin rreth çështjes së vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme, Gjykata duke ju referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, rikujton se GJEDNJ në parim çështjen e rëndësisë së përputhshmërisë së praktikës gjyqësore e ka ndërlidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të besimit të publikut në sistemin gjyqësor (Shih *mutatis mutandis* Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 28 tetorit 1999, *Brumărescu kundër Rumanisë*, nr. 28342/95, paragrafi 61; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 1 dhjetorit 2005; *Păduraru kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 63252/00, paragrafi 98; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 2 nëntorit 2010, *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 38155/02, paragrafi 38; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 25 prillit 2013; *Balažoski dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 45117/08 paragrafi 29; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 20 tetorit 2011, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 13279/05, paragrafi 52; shih gjithashtu

Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 10 majit 2012, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 34796/09 dhe 63 kërkesa të tjera, paragrafi 34, si dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2018, paragrafi 33).

106. Në këtë kontekst, GJEDNJ, përmes praktikës gjyqësore të saj, ka pohuar gjithashtu se kërkesat e parimit të sigurisë juridike dhe mbrojtjes legjitime të besimit të publikut nuk japin dhe as nuk garantojnë një të drejtë të fituar për përputhshmëri të praktikës gjyqësore (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 18 dhjetorit 2008, *Unédic kundër Francës*, Kërkesa nr. 20153/04, paragrafi 74; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 20 tetorit 2011; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 58; *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 34; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI142/15, *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri të 27 tetorit 2016, paragrafi 38).

107. GJEDNJ-ja, në mënyrë specifike ka nënvizuar se *"në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave, edhe nëse nxirren në procedura dukshëm të ngjashme; ajo duhet të respektojë pavarësinë e këtyre gjykatave [...]."* (Shih rastin *Ādamsons kundër Letonisë*, cituar më sipër, paragrafi 118, si dhe rastin *Nejdet Sahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50 dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI29/17, *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 tetorit 2017, paragrafi 47).

108. Sidoqoftë, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e kushteve në të cilat vendimet kundërthënëse të gjykatave të shkallës së fundit janë në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë. Në këtë kuptim, GJEDNJ thekson se duhet vërtetuar: a) nëse ekzistojnë dallime të thella dhe afatgjate në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit; b) nëse ligji i vendit parashikon mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve; dhe, c) nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe nëse po, deri në çfarë mase (Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 23530/02; Aktgjykim i 2 tetorit 2009, paragrafët 49-52; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI29/17, *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 tetorit 2017, paragrafi 51).

109. Gjykata vëren që në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kriteri i ekzistencës së "dallimeve të thella dhe afatgjate" është themelor në vlerësimin e konsistencës të praktikës gjyqësore (Shih *mutatis mutandis Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116-135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 23530/02; cituar më sipër, paragrafët 49-52; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53). Në këtë kontekst, GJEDNJ po ashtu ka konstatuar se duhet vlerësuar edhe efektin e një dallimi të tillë në raport me numrin e rasteve të tjera (Shih rastin *Abu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 10 qershorit 2012, paragrafi 38).

110. Gjykata nënvizon se nuk është detyrë e saj që të krahasojë vendime të ndryshme të Gjykatës Supreme dhe se ajo respekton në plotni pavarësinë e gjykatave të

rregullta. Gjykata ka parasysh se parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Pml. KZZ. 223/2014, të 11 qershorit 2018), e cila kishte konstatuar se përbërja e trupit gjykues vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it është në kundërshtim me ligjin, pretendojnë se Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe nga rasti i tyre, dhe si rrjedhojë mund të ketë rezultuar në cenimin e parimit të sigurisë juridike.

111. Megjithatë, Gjykata duke ju referuar praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së vlerëson se në bazë të vetëm një Aktgjykimi të Gjykatës Supreme, i cili pretendohet të jetë nxjerrë për raste të ngjashme nuk është e mundur të kuptohet dhe as të konstatohet se ka dallime të thella dhe afatgjata në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, e që do të mund të rrezikonte parimin e sigurisë juridike dhe rrjedhimisht të rezultonte në shkelje (Shih *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI29/17, *Adem Zhegrova*, cituar më lart, paragrafi 53).

112. Rrjedhimisht, Gjykata, duke ju referuar praktikës së saj dhe asaj të GJEDNJ-së dhe standardeve të vendosura përmes kësaj praktike, të cilat parime kjo Gjykatë i zbaton, e ka të pamundur të konstatojë se në rastin e parashtruesve të kërkesës janë plotësuar kriteret e ekzistencës së vendimeve kundërthënëse në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme.

III. Në lidhje me pretendimet parashtruesve e kërkesës KI176/18 për shkelje kushtetuese ndaj personit S. S.

113. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit e kërkesës KI176/18, pretendojnë edhe shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] nga Gjykata Supreme në lidhje me personin S. S.

114. Në lidhje me këtë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që është modalitet i ankesave individuale, dhe i mundëson çdo individi, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar për shkelje të të drejtave kushtetuese të një individi apo të një grupi të caktuar (Shih, *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/11, Aktvendimin për papranueshmëri, i 17 janarit 2013, paragrafi 26).

115. Gjykata vëren që, në lidhje me pretendimet për shkelje të drejtave kushtetuese të personit S. S., parashtruesve të kërkesës KI176/18, nuk kanë *locus standi* pranë Gjykatës. Gjykata vlerëson se individët, kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të autoriteteve publike që cenojnë të drejtat e tyre individuale dhe vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të përcaktuara me paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI102/17, parashtrues: *Meleq Imeri,* Aktvendim për papranueshmëri, i 10 janarit 2018, paragrafi 20).

116. Andaj, në kushtet kur kërkesa është parashtruar nga një palë e paautorizuar, Gjykata nuk mund të vlerësojë meritat e rastit dhe rrjedhimisht, as në rastin konkret, Gjykata nuk vlerëson pretendimet e parashtruesve të kërkesës KI176/18, nëse Aktgjykimi i kontestuar ka shkelur të drejtat kushtetuese të personit S. S., respektivisht nenin 29 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, nga arsyet e

lartpërmendura, Gjykata konstaton se kërkesa KI176/18, sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave kushtetuese të personit S. S. nuk është paraqitur në mënyrë ligjore nga një palë e autorizuar siç përcaktohet me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

117. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës 176/18, gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht ndalimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

118. Ndërsa parashtruesit e kërkesës KI06/19 kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *"pezullimin e procedurës së ekzekutimit të dënimeve nga Gjykata Themelore në Mitrovicë lëndët me numër ED: 123, 125, 126 dhe 127, deri në vendosje të kësaj lënde nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës"*.

119. Duke pasur parasysh se Gjykata tani ka vendosur lidhur me papranueshmërinë e kërkesës, nuk e konsideron të nevojshme që të shqyrtojë kërkesat e parashtruesve të kërkesës për miratimin e masës së përkohshme.

Përfundim

120. Gjykata, si përfundim konstaton se:

(i) Gjykata Supreme ka adresuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës me rastin e caktimit të trupit gjykues të Gjykatës Themelore, dhe rrjedhimisht vlerëson se pretendimet e tilla janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;

(ii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës KI183/18 për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës; dhe

(iii) Parashtruesit e kërkesës KI176/18, nuk janë palë e autorizuar për të ngritur shkelje të nenit 29 të Kushtetutës, në emër të personit S. S., siç përcaktohet me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (a) dhe (2), rregullin 59 (b) dhe rregullin 57 (1) të Rregullores së punës, më 13 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TË REFUZOJË kërkesat për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Nexhmi Rexhepi Arta Rama-Hajrizi